



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E ISTOGUT

## KONTRATË PËR PUNË

*KOMUNA E ISTOGUT në vazhdim "Njësia e Prokurimit", të cilën e përfaqëson znj, Zizë Bujupaj, menaxhere e Prokurimit, Rruga "Fadil Ferati" Nr. 121 në një tërësi anë;*

*dhe*

*Grupi I Operatoreve Shpk "HD KAB" & NNT A.B.C nga Istogu, të cilën e përfaqëson z. Hivzi Kabashi, në cilësinë e liderit të grupit me Nr. Rexh. Biznesi, 810089385 PERKATËSISHT 810438095 (në vazhdim "Kontraktuesit"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë të shënuara më poshtë:*

### TITULLI I KONTRATËS:

### NDËRTIMI I KANALIZIMIT NË CORROLLUKË- LOT 3

|                        |                                      |
|------------------------|--------------------------------------|
| <i>Nr. Irokurimit</i>  | <i>633-20/1276- 521/ C330– lot 3</i> |
| <i>Nr. I brendshëm</i> | <i>633 / 20 / 012 / 521</i>          |

### Neni 1 Lënda

*1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit:*

### NDËRTIMI I KANALIZIMIT NE CORROLLUKË

## **Neni 2 Çmimi**

2.1 Çmimi i punëve për punime **NDËRTIMI I KANALIZIMIT NE CORROLLUKË** është: **22.757,50 €** dhe me fjalë:  
*/Njëzetedymijëeshtatëçindenepesëdhjetëeshtatëeuro 50/100*

2.3. Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve përgjatë ekzekutimit të kontratës.

2.4. Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

## **Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës**

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

*Marrëveshja e kontratës;  
Kushtet e Veçanta të Kontratës;  
Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;  
Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet  
Teknike;  
Oferta financiare (Paramasa dhe Paralogaria);  
Plani për menaxhimin e kontratës*

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

## **Neni 4 Komunikimet**

4.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

4.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

4.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

**Për Autoritetin Kontraktues:**

**Komuna e Istogut**

**Per kontraktorin:**

**"HD KAB" shpk & N.N.T. A.B.C**

|                    |   |                    |   |
|--------------------|---|--------------------|---|
| <b>Emri:</b>       | <i>Zize Bujupaj</i>   | <b>Emri:</b>       | <i>Hivzi Kabashi</i>  |
| <b>Pozita:</b>     | <i>Zyrtar Pergjegjës i Prokurimit</i>   | <b>Pozita:</b>     | <i>L i d e r</i>  |
| <b>Nënshkrimi:</b> |  | <b>Nënshkrimi:</b> |  |
| <b>Data</b>        | <i>29/6/2020</i>  | <b>Data</b>        | <i>29/06/2020</i>   |
| <b>V u l a:</b>    |  | <b>V u l a</b>     |  |

Numri i Prokurimit: 633-20-1276-5-2-1///633/20/012/521 – Titulli Loto 1-Ndertimi i kanalizimit ne Baice-faza II, Loto 2-Ndertimi i kanalizimit ne Lubovë, Loto 3-Ndertimi i kanalizimit ne Corollukë,dhe Loto 4-Ndertimi i rrugës lagja Maksutaj-Haziraj Orroberd

### PJESA III E KONTRATES kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

| Kushtet e Përgjithshme të Kontratës                |           | Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK   |
|--|-----------|---|
| Përshkrimi i nenit                                 | Neni. Nr. |   |
| Ligji i zbatueshëm dhe gjuha                       | 2.1       | Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.  |
|  | 2.2       | Gjuha e përdorur do të jetë GJUHA SHQIPE  |
| Siguria e ekzekutimit                              | 10.1      | Shume e sigurisë së ekzekutimit është <i>10% e vlerës së përgjithshme të kontratës 10% e vlerës se kontrates, me vlefshmeri 30 dite me gjate perfundimi i kontrates.</i>  |
| Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit          | 11.2      | Shuma minimale e sigurimit do të jetë:<br>Sigurimi i vend punishtes do te jete përgjegjësi e Operatorit Ekonomik dhe te gjitha dëmtimet e punëve, dëmtimet e pronës apo humbjet e materialeve dhe pajisjeve ne vend punishte janë ne përgjegjësi te Operatorit ekonomik deri ne shumen e dëmtimeve apo humbjeve, sigurimi i vend punishtes do te jetë + 30 dite nga plani dinamik i ofruar pra nëse zgjasin punimet zgjatet edhe sigurimi i vend punishtes pra + 30 dite. |
| Fillimi i punëve                                   | 17.1      | Data e fillimit do të caktohet në <i>planin e menaxhimit</i>  |
|  | 17.2      | Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë <i>2muaj</i>   |
| Regjistri i punës                                  | 20.1      | Ditari i Punës dhe Libri ndërtimor  |
| Inspektimi dhe testimi                             | 22.1      | Menaxheri i Projektit është <i>i caktuar me vendim të ZKA</i>   |
| Shkaqet për kompensim                              | 30.1      | Data e posedimit të vend punimit do të jetë <i>5DITE</i> pas nënshkrimit të kontratës.  |
| Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve               | 42.2      | Palët do te provojnë ne mënyrë miqësore ti zgjidhin marrëveshjet ku do te organizojnë se paku tre takime për zgjidhje miqësore e nëse këto takime nuk kane efekt atëherë kompetente do te jetë gjykata.   |
| Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore | 43.1      | Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykata Themelore në Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë   |

**PARAMASA DHE PARALLOGARIA - NDËRTIMI I KANALIZIMIT FEKAL ( ujërave të zeza ) /  
Carallukë**

| Nr.      | Përshkrimi i punëve dhe materialeve  | Njësia | Sasia    | Çmimi më TVSH për njësi-<br>€ | Shuma-€         |
|----------|--|--------|----------|-------------------------------|-----------------|
| <b>1</b> | <b>Punët përgaditore</b>   |        |          |                               |                 |
| 1.1      | Mobilizimi i ndërmarrjes për fillimin e punimeve në projekt. Në çmim të llogaritet kosto e përpilimit të planit dhe programit punues si dhe e gjithë kosto e transportit dhe vendosjes së makinave dhe stafit punues si dhe akomodimi i përkohshëm i tyre.   | aprox  | 1.00     | 100.00                        | 100.00          |
| 1.2      | Kontrollimi dhe evidentimi i instalimeve nëntokësore, zgjedhja e problemeve eventuale që lidhen me planin operativ të ndërtimit si dhe përpilimi i planit detal operativ që lidhet me procesin e ndërtimit. Në çmim të llogaritet edhe kosto eventuale e detektimit me aparatura elektronike për instalime nëntokësore si dhe evidentimi i saktë i instalimeve që duhet të mirëmbahen gjatë kohës së ndërtimit (rrjeti elektrik, rrjeti telefonik, rrjeti i ujësjellësit, etj) | aprox  | 5.00     | 50.00                         | 250.00          |
| 1.3      | Fiksimi i pikave kontrolluese gjeodezike si dhe sigurimi fizikë i reperëve të rrjetës shtetërore. Në çmim të kalkulohet trasimi gjeodezik i vijave ku do të kalojë rrjeti i kanalizimit fekal si dhe përcjellja e punimeve me instrument gjeodezik.  | m      | 2,250.00 | 0.30                          | 675.00          |
|          |  |        |          | <b>Subtotali 1:</b>           | <b>1,025.00</b> |
| <b>2</b> | <b>Punët Demoluese</b>   |        |          |                               |                 |
| 2.1      | Demolimi i gypave të ndryshëm gjatë periudhës së ekzekutimit ngarkimi, transporti (maksimal 5 km prej punishtës) dhe shkarkimi i materialit të demoluar në deponinë legale ose në vendin të cilin e cakton Organi Mbikqyrës.   | aprox  | 1.00     | 50.00                         | 50.00           |
| 2.2      | Demolimi i pusëve prej betoni gjatë periudhës së ekzekutimit dhe materialeve tjera të cilat paraqitën pengje të rrjetës si dhe ngarkimi, transporti (maksimal 5 km prej punishtës) dhe shkarkimi i materialit të demoluar në deponinë legale ose në vendin të cilin e cakton Organi Mbikqyrës.   | aprox  | 1.00     | 50.00                         | 50.00           |
| 2.3      | Demolimi i gypave (beton, PE, dhe çelik) para hyrjeve të shtëpive, në çmim të përfshihet edhe rivendosja e tyre duke marrë parasysh në rast të deformimeve të gypave duhet të furnizohet i ri.   | aprox  | 1.00     | 50.00                         | 50.00           |
|          |  |        |          | <b>Subtotali 2:</b>           | <b>150.00</b>   |
| <b>3</b> | <b>Punët tokësore</b>  |        |          |                               |                 |
| 3.1      | Pastrimi i trasesë nga druajtë, shkurrët, rrethojat dhe pengesat tjera të cilat paraqitën pengje gjatë trasesë. Në çmim të llogaritet ngarkimi dhe transporti deri në deponinë legale.   | m'     | 500.00   | 0.30                          | 150.00          |
| 3.2      | Gërmimi i kanalit për kolektorët kryesor dhe sekondarë në kat. III - IV-të dheut dhe një pjesë e kanalit është kategori VII-VIII (200m), më makinë në gjërësi sipas normave dhe standardeve teknike (varësisht nga diametri i gypit) dhe thellësi sipas profilin gjatësor.   | m³     | 3,000.00 | 1.30                          | 3,900.00        |
| 3.3      | Gërmimi i kanalit për kolektorët kryesor dhe sekondarë në kat. III-IV të dheut, më dorë, në zgjerimet për puseta si dhe vendet ku nuk mund të punohet më makinë. Gjërësia e kanalit sipas normave dhe standardeve teknike (varësisht nga diametri i gypit) dhe thellësi sipas profilin gjatësor.   | m³     | 300.00   | 1.50                          | 450.00          |
| 3.4      | Sigurimi i kanalit nga shembja e dheut. Sigurimi bëhet me pahi të parapara sipas normave për këtë lloj pune, sipas detalit në projekt, në të dy anët e kanalit. Sigurimi bëhet për thellësit dhe kategorinë e tokës që janë të parapara më masat e mbrojtjes në punë. Sasitë janë indikative dhe punëkryesi në bashkpunim me organin mbikqyrës vendos se ku do të aplikohen këto masa. Rrjedhimisht të dy mbajnë përgjegjësinë për këtë proces                                 | m²     | 300.00   | 0.10                          | 30.00           |
| 3.5      | Planifikimi i fundit të kanalit me dorë me saktësi ±1cm. Ky planifikim duhet vertetuar nga organi mbikqyrës para vendosjes së rrerës.  | m²     | 1,800.00 | 0.10                          | 180.00          |
| 3.6      | Ngarkimi dhe transporti i dheut të gërmuar (tepërt) deri në deponinë qytetit ose në vendin ku e cakton organi mbikqyrës në largësi maksimale deri në 5km.  | m³     | 800.00   | 0.10                          | 80.00           |
| 3.7      | Furnizimi, transporti, shtrirja dhe planifikimi i rrerës nën, rreth dhe mbi gypat e kanalizimit më trashësi d=20cm fraksion 0-16 mm Ngjeshja të bëhet min 50 MPa   | m³     | 300.00   | 4.00                          | 1,200.00        |

## Komuna Istog

|                      |  |                |          |                           |                    |
|----------------------|--|----------------|----------|---------------------------|--------------------|
| 3.8                  | Furnizimi, transporti, shtrirja dhe planifikimi i zhavorrit, fraksion 0-63 mm t=15 cm për pjesën e rruës - bankinës në të cilën germoheti për vendosjen e kolektorit dhe ngjeshja për rregullimin e rrugës. Ngjeshja të bëhet min 80 Mpa                                   | m <sup>3</sup> | 100.00   | 4.00                      | 400.00             |
| 3.9                  | Mbulimi dhe planifikimi i kanalit me dhe të gërmuar dhe ngjeshja (min 30 MPa) në shtresa 30cm deri në kuoten e terrenit. Në çmimë të llogaritet edhe testet e ngjeshmërisë.  | m <sup>3</sup> | 3,000.00 | 0.20                      | 600.00             |
| 3.10                 | Prejra e asfaltit për gjatë rrugës më gjërsi bmes=1.0m për vendosjen gypit të kanalizimit, në çmimë të llogaritet vendosja zhavorit 0-16 t=15 cm si dhe riasfaltimi t=12 cm.   | m <sup>2</sup> | 12.00    | 10.00                     | 120.00             |
| 3.12                 | Shpimi horizontal me pjerrësi sipas projektit, nën rrugën e asfaltuar me diametër adekuat për të vendosur gypin mbrojtës nga qeliku, Ø500 mm. Në qmimë të përfshihet furnizimi dhe transporti i gypit.   | m'             | 6.00     | 60.00                     | 360.00             |
| 3.13                 | Largimi i ujërave nëntokësore me pompa. Ky pozicion është indikativ dhe është paraparë për rastin e paraqiten se uji në kanal gjatë egzekutimit.   | orë            | 10.00    | 5.00                      | 50.00              |
|                      |  |                |          | <b>Subtotali 3:</b>       | <b>7,520.00</b>    |
| <b>4</b>             | <b>Punët montuese</b>  |                |          |                           |                    |
|                      | Furnizimi, transporti dhe montimi i tubave të brinjëzuar PE SN8 për kolektorët e kanalizimit fekal.  |                |          |                           |                    |
| 4.1                  | PESN8 Ø250mm   | m'             | 2,000.00 | 3.50                      | 7,000.00           |
| 4.2                  | PESN8 Ø 200mm  | m              | 250.00   | 2.50                      | 625.00             |
|                      |  |                |          |                           | <b>7,625.00</b>    |
| 5.1                  | Furnizimi, transporti dhe vendosja e betonit për pllakën e poshtme për puseta me betonarme C- 20/25 d=20cm sipas detalit të paraqitur në projekt dhe të armuar konstruktivisht më armaturë Q-188 në të dy zonat.   | m <sup>3</sup> | 12.00    | 35.00                     | 420.00             |
| 5.2                  | Furnizimi, transporti dhe vendosja e betonimit për kineta më përpunim sipas detalit.   | m <sup>3</sup> | 14.00    | 35.00                     | 490.00             |
| 5.3                  | Furnizimi transporti dhe montimi i tubave (për puseta) prej betonit të armuar Ø1000/1000mm (elemente të parafabrikuar).  | copë           | 70.00    | 25.00                     | 1,750.00           |
| 5.4                  | Furnizimi transporti dhe montim i konuseve për puseta prej betonit Ø1000/700/600mm (elemente të parafabrikuar).  | copë           | 45.00    | 17.00                     | 765.00             |
| 5.6                  | Punimi dhe montimi i shkallëve prej armaturës Ø20 në çdo 30cm dhe inkastrimi i tyre në beton me lyrje antikorozive.  | copë           | 200.00   | 0.10                      | 20.00              |
| 5.7                  | Furnizimi, transporti, montimi i kapakeve nga betoni i armuar  | copë           | 45.00    | 12.00                     | 540.00             |
|                      |  |                |          | <b>Subtotali 5:</b>       | <b>3,985.00</b>    |
| <b>6</b>             |  |                |          |                           |                    |
| 6.1                  | Rregullimi i trases dhe pastrimi i punishtës.  | m              | 2,250.00 | 0.79                      | 1,777.50           |
| 6.2                  | Testimi i rrjetës së kanalizimit sipas udhëzimeve në raportin teknik respektivisht sipas standarteve duke pasur parasysh se pas çdo profili të ekzekutuar të behet testimi i rrjetës, nga kompanite profesionale.  | m'             | 2,250.00 | 0.10                      | 225.00             |
| 6.3                  | Inqizimi me CCTV Kamer dhe per çdo profile te dorzohen inqizimet dhe ne forme grafike (ne tri kopje te dorzohet raporti final mbi perfundimin e punimeve te dokumentuar me inqizimet e bera me CCTV Kamer - sipas profileve )  | m'             | 2,250.00 | 0.10                      | 225.00             |
| 6.4                  | Hartimi i projektit te ekzekutuar mbas perfundimit te ekzekutimit te punimeve ne teren ( pas çdo profili te ekzekutuar), qe nenkupton matjet gjeodezike dhe përpilimi i dokumentacionit teknik të punëve për punët e zbatuara si dhe dorëzimi të investitori në tri kopje. | m'             | 2,250.00 | 0.10                      | 225.00             |
|                      |  |                |          | <b>Subtotali 6:</b>       | <b>2,452.50</b>    |
| <b>REKAPITULLIMI</b> |  |                |          |                           |                    |
| <b>1</b>             | <b>Punët përgaditore</b>   |                |          |                           | <b>1,025.00 €</b>  |
| <b>2</b>             | <b>Punët demoluese</b>   |                |          |                           | <b>150.00 €</b>    |
| <b>3</b>             | <b>Punët tokësore</b>  |                |          |                           | <b>7,520.00 €</b>  |
| <b>4</b>             | <b>Punët montuese</b>  |                |          |                           | <b>7,625.00 €</b>  |
| <b>5</b>             | <b>Punët e betonit dhe armaturës</b>   |                |          |                           | <b>3,985.00 €</b>  |
| <b>6</b>             | <b>Punët tjera</b>   |                |          |                           | <b>2,452.50 €</b>  |
|                      |  |                |          | <b>Shuma e projektit:</b> | <b>22,757.50 €</b> |

